



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË
KORÇË

VENDIM

Nr 116 Datë 31.10.08

PER

Shtesë fondi për projektin "Punësimin sezonal të studentëve"

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës "Për shtesë fondi për projektin « punësimin sezonal të studentëve », bazuar në ligjin nr. 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 32 pika dh, ligjin nr. 9836 dt. 26.11.2007 «Për buxhetin e Shtetit të vitit 2008», Udhëzimin nr.4 dt.17.01.08 i M.F «Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2008», Udhëzimin nr 258 dt. 15.02.2008 i Ministrisë së Brendshme «Për zbatimin e buxhetit të qeverisjes vendore për vitin 2008 », V.K.B nr. 12 dt. 18.03.2008 «Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2008», Ligji nr. 9936 dt. 26.06.2008 «Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë» mbështetur në kompetencat që ka, mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë transferimin e fondit nga N.SH.M.A.C tek Bashkia për projektin e « Punësimi Sezonal » me këtë strukturë buxhetore :

Pakësohet NSHMAC	00	09120	05	Art 6020000	-	96,000
Shtohet Bashkia	00	01110	05	Art 6020000	+	96,000

2. Të miratojë transferimin e fondit prej 141,000 lekësh brenda strukturës së Bashkisë nga projekti i Buxhetimit me Pjesmarrje në projektin Punësimi Sezonal.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Drejtoria Juridike Drejtoria e Informimit Qytetar si dhe N.SH.M.A.C

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari

Raimonda Nase
Raimonda Nase